

**Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit  
Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.  
Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017  
(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)**

## **Përmbajtja**

Raporti i audituesve të pavarur i-iii

Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017:

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime për pasqyrat financiare	5–21



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355 (4) 2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionarët e Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Informacione të tjera*

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në raportin vjetor, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 75 të Ligjit 10197 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe përfshin pasqyrat financiare me raportin tonë të audituesit të pavarur. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

### *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016, janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi ato pasqyra financiare më 31 maj 2017.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.




Fatos Beqja  
Auditues Ligjor  
KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
Tiranë, 30 prill 2018


## Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	8	599,269	22,049
Depozita me afat	9	6,608,079	6,650,912
Investime në letra me vlerë	10	24,277,697	15,217,124
Pajisje	11	2,067,981	2,309,546
Aktive të tjera	12	2,443,443	1,856,561
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>35,996,469</b>	<b>26,056,192</b>
<b>DETYRIME</b>			
Detyrime të tjera	13	1,593,557	1,522,143
Tatim fitimi		1,067,004	390,029
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>2,660,561</b>	<b>1,912,172</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i paguar	14	57,028,800	57,028,800
Humbje të mbartura		(23,692,892)	(32,884,780)
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>33,335,908</b>	<b>24,144,020</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>35,996,469</b>	<b>26,056,192</b>

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Shoqërisë Shoqëria Administruese e Fondit te Pensionit Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a më datë 30 prill 2018 dhe u firmosën në emër të saj nga:

  
Naim Hasa  
Administrator



  
Junida Zavalani  
Drejtore e Financës

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga administrimi i fondit	15	24,801,337	17,724,620
Të ardhura nga interesi	16	1,075,740	1,055,530
<b>Të ardhura financiare neto</b>		<b>25,877,077</b>	<b>18,780,150</b>
Shpenzime për personelin	17	(11,084,497)	(10,932,111)
Amortizimi	11	(241,565)	(272,339)
Shpenzime administrative	18	(3,737,029)	(3,347,727)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(15,063,091)</b>	<b>(14,552,177)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>10,813,986</b>	<b>4,227,973</b>
Shpenzimi për tatim mbi fitimin	19	(1,622,098)	(780,029)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>9,191,888</b>	<b>3,447,944</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>9,191,888</b>	<b>3,447,944</b>



## **Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Humbje e mbartur</b>	<b>Totali</b>
Gjendja më 1 janar 2016	57,028,800	(36,332,724)	20,696,076
Fitimi i vitit	-	3,447,944	3,447,944
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën</i>	-	3,447,944	3,447,944
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>57,028,800</b>	<b>(32,884,780)</b>	<b>24,144,020</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	57,028,800	(32,884,780)	24,144,020
Fitimi i vitit	-	9,191,888	9,191,888
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën</i>	-	9,191,888	9,191,888
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>57,028,800</b>	<b>(23,692,892)</b>	<b>33,335,908</b>



## Pasqyra e flukseve monetare

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>10,813,986</b>	<b>4,227,973</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	11 241,565	272,339
Të ardhura nga investimi në letra me vlerë	(1,075,740)	(1,055,530)
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>	<b>9,979,811</b>	<b>3,444,782</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin punues</i>		
Ndryshime në aktive të tjera	(586,882)	(1,749,497)
Ndryshime në detyrime të tjera	71,414	101,537
<b>Flukset e parasë nga ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative</b>	<b>(515,468)</b>	<b>(1,647,960)</b>
Tatim fitimi i paguar	(945,123)	-
Interesi i arkëtuar	1,058,000	1,033,999
<b>Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet operative</b>	<b>9,577,220</b>	<b>2,830,821</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>		
Rritje në depozita me afat	-	(4,000,000)
Rritje në investime	(9,000,000)	-
<b>Flukse monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	<b>(9,000,000)</b>	<b>(4,000,000)</b>
Rënia neto në flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre	577,220	(1,169,179)
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	22,049	1,191,228
<b>Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës</b>	<b>8 599,269</b>	<b>22,049</b>

## **1. Informacione të përgjithshme**

Shoqëria administruese e fondit të pensioneve (Sh.A.F.P) Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria"), është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Shqipëri. Shoqëria është e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit, Tiranë Nr. 34877, më datë 21 janar 2006.

### **Aktiviteti Kryesor**

Më 30 Mars 2011, Autoriteti shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") licenoi "Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a" për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit.

### **Adresa e regjistruar**

Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në rrugën "Bulevardi Zogu I", Nr.1, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet 51% nga SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA dhe 49% nga z. Avni Ponari. Shoqëria mëmë dhe pala kontrolluese është Uniqa Insurance AG. Operacionet drejtohen nga bordi mbikëqyrës që përbëhet nga pesë anëtarë: Z. Adrian Totokoçi, Z.Klement Mersini, Z.Naim Hasa, Z.Abdyl Sarja, Z.Edvin Hoxhaj

Bordi Mbikëqyrës ka emëruar z. Naim Hasa si Administrator i Shoqërisë. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka 6 punonjës (2016: 6 punonjës).

Shoqëria Administruese dhe Depozituesi duhet të mbajnë aktivet, operacionet dhe regjistrimet e fondit të pensionit veçmas nga aktivet, operacionet dhe regjistrimet e tyre. Prandaj, të dhënat e kontabilitetit të Fondit të pensionit dhe të Shoqërisë Administruese mbahen veçmas dhe pasqyrat financiare përkatëse përgatiten gjithashtu veçmas.

## **2. Bazat e Kontabilitetit**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë janë të përfshira në Shënimin 4.

## **3. Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

## **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### **(a) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **(b) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë që maten me koston historike në monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit në përgjithësi njihen në fitim ose humbje.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(c) Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit pagesat dhe arkëtimet e ardhshme në të holla nëpërmjet jetës së pritshme të aktivitetit ose pasivitetit financiar (ose, sipas rastit, një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose pasivitetit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit financiar dhe mund të rishikohet në bazë të kushteve kontraktuale. Norma efektive e interesit për detyrimet financiare përcaktohet në njohjen fillestare dhe rishikohet më vonë në bazë të kushteve kontraktuale.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranuar, kostot e transaksionit dhe uljet ose primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, lëshimit ose shitjes së një aktivi ose pasivi financiar.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me koston e amortizuar në bazë të normës efektive të interesit.

##### **(d) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të ofruara nga Shoqëria. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përfshirë tarifën e administrimit llogariten si shërbimi përkatës. Tarifa e tërheqjeve të parakohshëm llogaritet mbi aktivet neto të kontribuuesit në ditën e tërheqjes.

Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

##### **(e) Pagesat e qirasë**

Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

##### **(f) Përfitimet e punonjësve**

###### *(i) Kontributet e detyrueshme*

Shoqëria kryen kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore janë përgjegjëse për sigurimin e pragut minimal të përcaktuar ligjërisht për pension sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara. Kontributi i Shoqërisë në planin e përfitimit të pensionit ngarkohen në fitimin dhe humbjen si ndodhin.

###### *(ii) Lejet vjetore të paguara*

Shoqëria njih si një detyrim shumë të paskontuar të kostove të llogaritura lidhur me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

##### **(g) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjokat që lidhen me tatimin mbi fitimin, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas *SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*.

###### *(i) Tatimi aktual mbi fitimin*

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë nga Shoqëria të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Tatim fitimi aktual i arkëtueshëm ose i pagueshëm kompensohet vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(g) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

###### *(ii) Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në planet e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet; Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është bërë e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyrë vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

##### **(h) Instrumentet financiarë**

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera të mbajtura deri në maturim dhe detyrimet financiare jo-derivative.

###### *(i) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare jo-derivative - Njohja dhe çregjistrimi*

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato kanë origjinën.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar, ose as nuk transferon dhe as ruan në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin mbi aktivin e transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria njihen si një aktiv ose pasiv i veçantë.

Shoqëria çregjistron një pasiv financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria aktualisht ka një të drejtë të detyrueshme ligjrisht për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë pasuri dhe shlyer detyrimin në të njëjtën kohë.

###### *(ii) Aktivet financiare jo-derivative - Matja*

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

###### *(iii) Detyrimet financiare jo-derivative - Matja*

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

###### *(iv) Netimi*

Aktivet dhe detyrimet financiare janë nisur dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti i Shoqërisë.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(h) Instrumentet financiarë (vazhdim)**

###### *(v) Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose të paguar për të transferuar një pasiv në një transaksion të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në parimin, ose në mungesë të saj, tregu më i favorshëm në të cilin shoqëria ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e mos-performancës. Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysht në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

###### *(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare janë të zhvlerësuara kur evidencat objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivit që mund të maten me besueshmëri.

Prova objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë vonesat ose vonesat nga një huamarrës, ristrukturimin e një huaje ose avancimi me kushte që Shoqëria nuk do ta konsideronte ndryshe, tregues se huamarrësi do të hyjë në falimentim ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup aktivesh të tilla si ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësve ose kushtet ekonomike që lidhen me dështime në grup.

Shoqëria konsideron dëshmi të zhvlerësimit në të dy nivelet kolektive dhe specifike. Kreditë në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku huamarrësit me karakteristika të ngjashme të kredisë. Kreditë në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmive objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të kredive të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe delikuencës së më shumë se 90 ditëve për një huamarrës të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(i) Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat afatgjata me maturim fillestar më shumë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat në banka si nënkategori e huave dhe aktiveve financiare të arkëtueshme.

##### **(j) Depozitat me afat**

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

##### **(k) Investime në letrat me vlerë**

Investimet në letrat me vlerë janë investime borxhi që Shoqëria ka synimin dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim dhe klasifikohen si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synojnë të mbahen deri në maturim, maten më pas me koston e amortizuar, minus provizioni për zhvlerësim në vlerë. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo skontim ose prim në blerje.

##### **(l) Pajisje**

###### *(i) Njohja dhe matja*

Pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të atribuueshme për blerjen e aktivitetit. Kur pjesët e një sendi të pronës dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pasurive dhe pajisjeve. Çdo fitim ose humbje nga shitja e një zëri të pajisjeve (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit) njihen me të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

###### *(ii) Shpenzimet e mëvonshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pajisjeve njihet në vlerën kontabël të zërit në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të integruara brenda pjesës do të derdhen në Shoqëri dhe kostot e saj mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e mirëmbajtjes së përditshme të pajisjeve njihen në fitim ose humbje si të ndodhura.

###### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilës pjesë të një zëri të aktiveve dhe pajisjeve. Aktivitetet e huazuara me qira financiare zhvlerësohen gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Instalime kompjuterike	4 vjet
Mjete transporti	10 vjet
Pajisje zyre	10 vjet

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

##### **(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Në fund të çdo periudhe raportuese, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(n) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara**

Disa Standarde të reja, ndryshime të Standardeve dhe Interpretimeve ekzistuese janë në fuqi për periudha vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2017; gjithsesi, nuk janë zbatuar nga Shoqëria në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

##### **SNRF 9 Instrumentet financiare**

SNRF 9, i publikuar në korrik 2014 zëvendëson interpretimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin interpretime të rishikuara në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së pritur të kreditit për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të kontabilitetit të mbrojtjes. SNRF 9 është efektiv për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018 me mundësinë e aplikimit të mëhershëm. Drejtimi nuk pret që standardi i ri, kur të aplikohet fillimisht, të ketë ndikim material në pasqyrat financiare.

##### **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendëson standardet ekzistuese për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë IAS 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Konsumatorëve.

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm.

Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë, Drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë. Koha dhe matja e të ardhurave të Shoqërisë nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Shoqërisë dhe llojit të të ardhurave që ajo realizon.

##### **SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira, KIS-15 Qiratë Operative - Stimujt dhe KIS-27 Vlerësimi i Përbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje.

Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Zbatimi i hershëm është i lejuar për subjektet që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njuh një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative.

Shoqëria ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Shoqërisë në atë datë, vlerësimin më të fundit të Shoqërisë nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Shoqëria do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktivet dhe detyrimet e reja për qiratë operative të zyrave. Më 31 Dhjetor 2017, pagesat minimale të ardhshme të qirasë së Shoqërisë sipas qirasë operative arritën në 385 mijë Lek (shih shënimin 20).

Përveç kësaj, natyra e shpenzimeve që lidhen me këto qira do të ndryshojë tani pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e drejtpërdrejta të qirasë së qirasë me një zhvlerësim për aktivet e së drejtës së përdorimit dhe shpenzimet e interesit mbi detyrimet e qirasë.



#### **4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**

##### **(n) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara (vazhdim)**

###### **Standarde të tjera**

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28;
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2);
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40);
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);
- KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj;
- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23);
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19)

## **5. Administrimi i rrezikut financiar**

Shoqëria ka ekspozim ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare :

- rreziku kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim përmban informacion në lidhje me ekspozimin e kompanisë ndaj rreziqeve të renditura më sipër, dhe politikat dhe procedurat për menaxhimin e këtyre rreziqeve.

### **Kuadri i administrimit të rrezikut**

Në përputhje me ligjin nr. 10197 datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Shoqëria ka krijuar një funksion të veçantë të dedikuar për administrimin e rrezikut. Roli i administrimit të rrezikut në strukturën e Shoqërisë nënkupton përgjegjësinë në lidhje me administrimin e rreziqeve që raportojnë drejtpërdrejt në Bordin Mbikëqyrës. Politika e administrimit të rrezikut është zhvilluar në bazë të strukturës themelore të Fondit të Pensionit të administruar nga shoqëria dhe tolerancës së rrezikut të paraqitur në politikën e investimeve të Fondit dhe kërkesat e legjislacionit të Fondit të Pensionit administrojnë një plan kontributësh të përcaktuar ku kontributet janë të sigurta ndërsa përfitimet mbeten të pasigurta . Administrimi i rrezikut financiar në Shoqëri fillon nga identifikimi i rreziqeve, vendosja e burimeve të përshtatshme për administrimin e rrezikut, përcaktimi i limiteve mbi ekspozimet, kufizimet e monitorimit dhe rregullimi i ekspozimeve ndaj intervaleve të kërkuara

Kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative ; aprovimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit.

Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e Komitetit Investues si më poshtë:

- Z. Naim Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese.
- Z. Klement Mersini, Drejori Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Z. Ilir Hoti, Konsulent Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Znj. Esmeralda Shehaj, Pedagoqe e Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe Konsulente mbi investimet dhe menaxhimin e rrezikut.

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë alokimin dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riskut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimum të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

## 5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### 5.1 Rreziku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe pasivet që sjellin interesa dhe (c) instrumentet e kapitalit neto, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut paraqitet më poshtë dhe ato bazohen në një ndryshim në një faktor, duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj

#### a) Rreziku i monedhës

Shoqëria kryen transaksione në valutë vendore dhe të huaja; prandaj paraqiten ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Risku i kursit të këmbimit paraqitet si vlera e transaksioneve të ardhshme dhe aktivet monetare të njohura dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të tjera luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve / detyrimeve. Norma e aplikueshme zyrtare e Bankës (Lek në njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
USD	111.10	128.17
Euro	132.95	135.23

Ekspozimet në valutë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjeve të pafavorshme në kurset e këmbimit valutor. Nuk ka aktive financiare ose detyrime financiare në monedha të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

#### 31 dhjetor 2017

Aktivitet	LEK	EUR	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	599,269	-	599,269
Depozita me afat	6,608,079	-	6,608,079
Investime në letra me vlerë	24,277,697	-	24,277,697
Aktive të tjera financiare	2,196,446	-	2,196,446
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>33,681,491</b>	-	<b>33,681,491</b>
<b>Detyrime</b>			
Detyrime të tjera	1,175,963	-	1,175,963
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,175,963</b>	-	<b>1,175,963</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>32,505,528</b>	-	<b>32,505,528</b>

#### 31 dhjetor 2016

Aktivitet	LEK	EUR	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	22,049	-	22,049
Depozita me afat	6,650,912	-	6,650,912
Investime në letra me vlerë	15,217,124	-	15,217,124
Aktive të tjera financiare	1,687,891	-	1,687,891
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>23,577,976</b>	-	<b>23,577,976</b>
<b>Detyrime</b>			
Detyrime të tjera	1,040,825	-	1,040,825
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,040,825</b>	-	<b>1,040,825</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>22,537,151</b>	-	<b>22,537,151</b>

**5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)**

**b) Rreziku i normës së interesit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të instrumenteve të saj financiarë të luhaten si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Periudha për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon pra në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Një përmbledhje e pozicionit të hendekut të normës së interesit të Shoqërisë, i analizuar me datën e rivlerësimit kontraktual ose me datën e maturimit, është si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>Më pak se një muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 muaj deri në një vit</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<b>Aktivitet financiarë</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	599,269	599,269	-	-	-
Depozita me afat	6,608,079	-	2,600,211	4,007,868	-
Investime në letra me vlerë	24,277,697	-	-	277,697	24,000,000
Aktive të tjera financiare	2,196,446	2,196,446	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>33,681,491</b>	<b>2,795,715</b>	<b>2,600,211</b>	<b>4,285,565</b>	<b>24,000,000</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Detyrime të tjera	1,175,963	1,175,963	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,175,963</b>	<b>1,175,963</b>	-	-	-
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>32,505,528</b>	<b>1,619,752</b>	<b>2,600,211</b>	<b>4,285,565</b>	<b>24,000,000</b>
<hr/>					
<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>Më pak se një muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 muaj deri në një vit</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<b>Aktivitet financiarë</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	22,049	22,049	-	-	-
Depozita me afat	6,650,912	-	2,620,056	4,030,856	-
Investime në letra me vlerë	15,217,124	-	-	217,124	15,000,000
Aktive të tjera financiare	1,687,891	1,687,891	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>23,577,976</b>	<b>1,709,940</b>	<b>2,620,056</b>	<b>4,247,980</b>	<b>15,000,000</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Detyrime të tjera	1,040,825	1,040,825	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,040,825</b>	<b>1,040,825</b>	-	-	-
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>22,537,151</b>	<b>669,115</b>	<b>2,620,056</b>	<b>4,247,980</b>	<b>15,000,000</b>

Rritja/ulja paralele e kurbës së yield-eve me 100 pikë përqindjeje për portofolin e letrave me vlerë dhe depozitave me të ardhura fikse do të ndikonte ndikimin neto të Shoqërisë me një fitim / humbje prej 306,000 Lek (2016: 218,680 Lek).

## 5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### 5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

#### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë hua ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Politika e Shoqërisë është të investojë në letra me vlerë që do të mbahen deri në maturim. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 është paraqitur në tabelën e mëposhtme::

31 dhjetor 2017	Vlera kontabël	Flukset kontraktuale	Më pak se një muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në një vit	1 deri në 5 vjet
<b>Aktivët financiarë</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	599,269	599,269	599,269	-	-	-
Depozita me afat	6,608,079	6,637,000	-	2,613,000	4,024,000	-
Investime në letra me vlerë	24,277,697	25,326,500	-	-	-	25,326,500
Aktive të tjera financiare	2,196,446	2,196,446	2,196,446	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>33,681,491</b>	<b>34,759,215</b>	<b>2,795,715</b>	<b>2,613,000</b>	<b>4,024,000</b>	<b>25,326,500</b>
<b>Detyrimet financiare</b>						
Detyrime të tjera	1,175,963	1,175,963	1,175,963	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,175,963</b>	<b>1,175,963</b>	<b>1,175,963</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Hendeku neto i maturimit</b>	<b>32,505,528</b>	<b>33,583,252</b>	<b>1,619,752</b>	<b>2,613,000</b>	<b>4,024,000</b>	<b>25,326,500</b>
<b>Efekti i akumuluar</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,619,752</b>	<b>4,232,752</b>	<b>8,256,752</b>	<b>33,583,252</b>
<hr/>						
31 dhjetor 2016	Vlera kontabël	Flukset kontraktuale	Më pak se një muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në një vit	1 deri në 5 vjet
<b>Aktivët financiarë</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	22,049	22,049	22,049	-	-	-
Depozita me afat	6,650,912	6,642,200	-	-	6,642,200	-
Investime në letra me vlerë	15,217,124	19,591,500	-	-	1,034,000	18,557,500-
Aktive të tjera financiare	1,687,891	1,687,891	1,687,891	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>23,577,976</b>	<b>27,943,640</b>	<b>1,709,940</b>	<b>-</b>	<b>7,676,200</b>	<b>18,557,500-</b>
<b>Detyrimet financiare</b>						
Detyrime të tjera	1,040,825	1,040,825	1,040,825	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,040,825</b>	<b>1,040,825</b>	<b>1,040,825</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Hendeku neto i maturimit</b>	<b>22,537,151</b>	<b>26,902,815</b>	<b>669,115</b>	<b>-</b>	<b>7,676,200</b>	<b>18,557,500-</b>
<b>Efekti i akumuluar</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>669,115</b>	<b>669,115</b>	<b>8,345,315</b>	<b>26,902,815-</b>

### 5.2 Rreziku i kredisë

Emetuesit e instrumenteve të borxhit të përfshira në portofol mund të dështojnë në pagesën e interesit dhe të principalit. Përkeqësimi i cilësisë së kredisë nënkupton gjithashtu uljen e vlerës së tregut dhe likuiditetin për instrumentin bazë. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë.

Kategoria	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8	599,269	22,049
Depozita me afat	9	6,608,079	6,650,912
Investime në letra me vlerë	10	24,277,697	15,217,124
Aktive të tjera financiare	12	2,196,446	1,687,891
<b>Vlera kontabël</b>		<b>33,681,491</b>	<b>23,577,976</b>

Aktivët financiarë të Shoqërisë nuk janë as me vonesa as të zhvlerësuar në datën e raportimit. Cilësia e kredisë është dhënë në shënimet përkatëse.

## **5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **Administrimi i kapitalit**

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga kapitali që i takon zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë, duke përfshirë kapitalin, rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Shoqëria menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që nivelet e mjaftueshme të kapitalit të mirëmbahen për të qenë në gjendje të vazhdojnë biznesin si dhe të jenë në përputhje me kërkesat e kapitalit të rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin e palëve të interesuara. Minimumi i kapitalit të kërkuar të përcaktuar me nenin 21 të ligjit nr. 10197 datë 12.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" është Lek 15,625,000. Më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, Shoqëria ka përmbushur të gjitha kërkesat për kapital.

### **6. Vlerësimet dhe gjykime kritike të kontabilitetit**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur.

### **7. Paraqitja me vlerën e drejtë**

Shoqëria duhet të klasifikojë, për qëllim paraqitjeje, matjet me vlerë të drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që të reflektojë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes.

#### ***Përcaktimi i vlerës së drejtë***

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar në treg ose çmimet e kuotuar për instrumente financiare të tregtuara në tregje aktive. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare, vlera e drejtë përcaktohet me teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika në vlerë aktuale neto, metodën e fluksit të skontuar të parasë, krahasime me instrumente të ngjashme për të cilët ekzistojnë çmime të matshme tregu, dhe modele vlerësimi.

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve, që shpjegohet si më poshtë:

Niveli 1: Çmimi i tregut i kuotuar (i pa rregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik.

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në të dhëna të vrojtueshme, në mënyrë direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmime tregu të kuotura në tregje aktive për instrumente të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime të kuotuar tregu ose çmime kuotacionesh nga tregtarët. Për instrumente financiare që tregtohen rrallë dhe nuk ka transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon grada të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet e çmimeve dhe risqe të tjera që influencojnë instrumentin specifik.

#### ***Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre***

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë gjendjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë barazohet me vlerën që mbartin në datën e raportimit.

#### ***Investime në letra me vlerë***

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Vlera e drejtë për këto letra me vlerë është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të skontuara bazuar në një kurbë korrente të yield-eve të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim.

## 7. Paraqitja me vlerën e drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme analizon së bashku me vlerën e drejtë aktivet financiare të Shoqërisë sipas niveleve matur me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016.

	Niveli i vlerës së drejtë	Të mbajtura deri në maturim	Kredi dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera kontabël e mbartur	Vlera e drejtë
<b>31 dhjetor 2017</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	Niveli 2	-	599,269	-	599,269	599,269
Depozita me afat	Niveli 2	-	6,608,079	-	6,608,079	6,608,079
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	24,277,697	-	-	24,277,697	30,506,669
<b>31 Dhjetor 2016</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	Niveli 2	-	22,049	-	22,049	22,049
Depozita me afat	Niveli 2	-	6,650,912	-	6,650,912	6,650,912
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	15,217,124	-	-	15,217,124	20,911,801

## 8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në arkë	-	-
Mjete monetare në bankë	599,269	22,049
<b>Total</b>	<b>599,269</b>	<b>22,049</b>

Më 31 dhjetor 2017, mjetet monetare të Shoqërisë mbahen nga Tirana Bank, një filial i Bankës Piraeus Greqi e cila është vlerësuar me C nga S&P me një perspektivë të qëndrueshme.

## 9. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat përfshijnë depozitën e mëposhtme në lekë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Depozita me afat	6,600,000	6,600,000
Interesi i përlogaritur	8,079	50,912
<b>Totali</b>	<b>6,608,079</b>	<b>6,650,912</b>

Interesi i aplikuar në depozitat me afat varion nga 0.5% - 0.7% (2016: 0.6% - 0.7%). Depozitat me afat të shoqërisë cilësohen si as të vonuara as të zhvlerësuar. Ato janë vendosur në Tirana Bank, filial i Piraeus Bank i vlerësuar me C nga S&P më 31 dhjetor 2017.

## 10. Investime në letra me vlerë

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Obligacione qeveritare	24,000,000	15,000,000
Interesi i përlogaritur	277,697	217,124
<b>Totali</b>	<b>24,277,697</b>	<b>15,217,124</b>

Maturimi i letrave me vlerë varion nga 2 deri në 7 vjet dhe me norma interesi që variojnë nga 3.25% to në 7.78%.

Investimet në letra me vlerë janë cilësuar si as të vonuara as të zhvlerësuar. Përbehen nga obligacione qeveritare dhe vlerësimi i Shqipërisë sipas Moody's është B1 me një perspektivë të qëndrueshme.



**Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.**  
(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

**11. Pajisje**

	Pajisje zyre	Pajisje kompjuterike	Mjete transporti	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 1 janar 2016	1,266,818	645,637	4,041,000	<b>5,953,455</b>
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,266,818</b>	<b>645,637</b>	<b>4,041,000</b>	<b>5,953,455</b>
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,266,818</b>	<b>645,637</b>	<b>4,041,000</b>	<b>5,953,455</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Më 1 janar 2016	737,607	532,681	2,101,282	<b>3,371,570</b>
Amortizimi i vitit	51,952	26,453	193,934	<b>272,339</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>789,559</b>	<b>559,134</b>	<b>2,295,216</b>	<b>3,643,909</b>
Amortizimi i vitit	49,339	17,686	174,540	<b>241,565</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>838,898</b>	<b>576,820</b>	<b>2,469,756</b>	<b>3,885,476</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>Më 1 janar 2016</b>	<b>529,211</b>	<b>112,956</b>	<b>1,939,718</b>	<b>2,581,885</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>477,259</b>	<b>86,503</b>	<b>1,745,784</b>	<b>2,309,546</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>427,920</b>	<b>68,815</b>	<b>1,571,244</b>	<b>2,067,981</b>

**12. Aktive të tjera**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme për tarifat e administrimit të "Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal"	2,196,446	1,687,891
Aktive të tjera	246,997	168,670
<b>Totali</b>	<b>2,443,443</b>	<b>1,856,561</b>

Të arkëtueshmet për tarifën e administrimit përbëjnë tarifën e arkëtueshme nga fondi i pensionit i administruar nga Shoqëria.

**13. Detyrime të tjera**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë	1,175,963	1,040,825
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatime të tjera	330,986	370,431
Të tjera	86,608	110,887
<b>Totali</b>	<b>1,593,557</b>	<b>1,522,143</b>

#### 14. Kapitali aksionar

Struktura aksionare më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	%	Nr. i aksioneve	Ekivalenti Në Lek	%	Nr. i aksioneve	Ekivalenti Në Lek
Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a	51	24,237	29,084,688	51	24,237	29,084,688
Avni Ponari	49	23,287	27,944,112	49	23,287	27,944,112
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>47,524</b>	<b>57,028,800</b>	<b>100</b>	<b>47,524</b>	<b>57,028,800</b>

Tabela e mëposhtme rakordon numrin e aksioneve në qarkullim në fillim dhe në fund të periudhës:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Numri i aksioneve të autorizuara dhe të paguara plotësisht në fillim të periudhës	47,524	47,524
Numri i aksioneve të lëshuara gjatë periudhës	-	-
<b>Numri i aksioneve të autorizuara dhe të paguara plotësisht në fund të periudhës</b>	<b>47,524</b>	<b>47,524</b>

Minimumi i nevojshëm i kapitalit aksionar i përcaktuar nga artikulli 21 i ligjit nr. 10197 më datë 12 dhjetor 2009 "Mbi fondet vullnetare të pensioneve" është 15,625,000 lekë.

#### 15. Të ardhura nga administrimi i fondeve

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tarifa e administrimit	22,764,634	16,804,094
Tarifa për mbyllje të parakohshme	2,036,703	920,526
<b>Totali</b>	<b>24,801,337</b>	<b>17,724,620</b>

Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore, si 3% e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit. Komisionet për mbyllje të parakohshme, paguar nga kontribuuesit për tërheqjen e parakohshme të kontributeve është llogaritur si përqindje e vlerës së fondit të kontribuuesit neto (duke përfshirë tatimin në burim) në ditën e tërheqjes. Kjo përqindje varjon nga 2 deri në 15%, në varësi të periudhës që kontribuesi ka investuar në fond.

#### 16. Të ardhura nga interesi

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat e obligacioneve	1,037,872	1,034,000
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	37,868	21,530
<b>Total</b>	<b>1,075,740</b>	<b>1,055,530</b>

**Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.**  
(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

**17. Shpenzime personeli**

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Shpenzime personeli	10,126,657	10,092,473
Sigurime shoqërore	814,164	714,401
Sigurime shëndetësore	143,676	125,237
<b>Total</b>	<b>11,084,497</b>	<b>10,932,111</b>

Numri total i punonjësve më 31 dhjetor 2017 ishte 6 (2016: 6 punonjës).

**18. Shpenzime Administrative**

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Tarifë depozitari	1,517,643	1,120,273
Qira	420,000	420,000
Shërbime konsulence	489,155	397,410
Programe kompjuterike	326,520	366,257
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	292,468	347,425
Reklama dhe publicitet	92,933	190,713
Taksa dhe tarifa	121,000	165,133
Shpenzime përfaqësimi	166,175	141,850
Komisione bankare	89,223	110,908
Telefon	60,473	66,203
Mirëmbajtje	104,904	11,480
Të tjera	56,535	10,075
<b>Total</b>	<b>3,737,029</b>	<b>3,347,727</b>

Pagesa e depozitarit llogaritet në baza ditore, si 0.2% e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit. Pagesa e AMF llogaritet në baza mujore si 0.05% e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit.

**19. Tatim fitimi**

Llogaritja vjetore e tatim fitimit është si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Tatim fitimi aktual	1,622,098	780,029
Tatim fitimi i shtyrë	-	-
<b>Tatim fitimi</b>	<b>1,622,098</b>	<b>780,029</b>

Një rakordim i shpenzimit të tatim fitimit për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<b>2017</b>		<b>2016</b>	
Fitimi për periudhën	10,813,986		4,227,973	
Tatim fitimi sipas normës së përqindjes vendore	15%	1,622,098	15%	634,196
Shpenzime jo të zbritshme	-	-	3.4%	145,833
	<b>15%</b>	<b>1,622,098</b>	<b>18.4</b>	<b>780,029</b>

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2017 është 15% (2016: 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final.

Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

**20. Angazhime dhe detyrime të konstatuara**

**a) Ligjore**

Në kursin normal të biznesit Shoqëria merr pretendime ligjore, të cilat nuk i përkasin thelbit së biznesit. Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk do të ndodhin humbje materiale në lidhje me ndonjë pretendim ligjor deri më 31 dhjetor 2017.

**b) Detyrime qiramarrje**

Shoqëria ka hyrë në angazhime për qira për objektet e saj. Pagesat e ardhshme minimale në bazë të qirasë operative jo të anulueshme janë si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Deri në 1 muaj	35,000	35,000
Deri në 6 muaj	-	-
Deri në 1 vit	-	-
<b>Totali</b>	<b>35,000</b>	<b>35,000</b>

Pagesat e ardhshme minimale të Shoqërisë sipas qirasë operative të anulueshme arritën në 385 mijë Lek.

**c) Angazhime të tjera**

Shoqëria nuk ka angazhime për shpenzime kapitale më 31 dhjetor 2017.

**21. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie me palët e lidhura të mundshme, fokusi është drejtuar drejt substancës së marrëdhënies dhe jo formës juridike. Palët e lidhura me të cilat Shoqëria ka pasur transaksione janë të shënuara më poshtë:

<b>Pala e lidhur</b>	<b>Marrëdhënia</b>
Sigal Uniqa Group Austria Sh.a.	Shoqëria mëmë e grupit në Shqipëri
Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.	Shoqëria mëmë
Avni Ponari	Aksionar
Naim Hasa	Drejtor i përgjithshëm
Voluntary Pension Fund Sigal	Fondi i pensionit

Gjatë vitit Shoqëria ka pasur këto transaksione me palët e lidhura:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Të ardhura nga:</b>		
<b>Shpenzime për:</b>		
Stafi kyç drejtues	3,542,500	3,835,860
	<b>3,542,500</b>	<b>3,835,860</b>

**22. Njësi të strukturuar të pa konsoliduara**

Tabela në vijim paraqet informacionin e njësisë së vetme të strukturuar, Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, të cilin Shoqëria administron por nuk konsolidon.

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Të ardhurat e fituara nga administrimi	22,764,634	16,804,094
Asetet neto totale nën administrim	875,279,402	672,690,158

Ekspozimi maksimal ndaj humbjes së Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017 në lidhje me njësinë e strukturuar të pakonsoliduar, është vlera kontabël e tarifave të arkëtueshme të administrimit në shumën 2,196 mijë Lekë (2016: 1,687 mijë Lekë).

**23. Ngjarje pas datës së raportimit**

Personeli drejtues nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje pas datës së raportimit, e cila do të kërkonte korrigjime apo shënime të tjera shpjeguese në pasqyrat financiare.